**Nr 1969 Prot** **Durrës më 20.02.2020**

**URDHËR**

**PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE**

**Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT**

**TIRANË**

Në Durrës sot më datë 20.02.2020

Unë **HARILLA A. ÇIPI** Përmbarues Gjyqësor Privat me çertifikatë nr. 244 dhe Administrator i Shoqërisë Përmbarimore Gjyqësore Private **"PETANI BAILIFF'S OFFICE"shpk** pasi studiova dosjen përmbarimore si dhe në zbatim të Urdhërit të Ekzekutimit nr 1215(11-2019-6325) datë 07.11.2019 , të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**KONSTATOVA**

Se në datën 14.01.2020 Kreditori Lorenc Dake ka paraqitur pranë Shoqërisë Përmbarimore Gjyqësore Private **"PETANI BAILIFF'S OFFICE"** shpk kërkesën për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv Vendimin Nr. (11-2018-1735) 601, datë 16.04.2018 me palë:

- **Kreditor : Lorenc Dake**
- **Debitor : Drejtoria Rajonale O.SH.E.E. Durrës me NIPT K72410014H**
- **Me objekt : Kthim Page**

**Në zbatim të titullit ekzekutiv është vendosur detyrimi i palës Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.A. (*OSHEE*) në favor të kreditorit Lorenc Dake** . Në kushtet kur ekzekutimi paraqet vështirësi për likujdim pasi pala debitore mund të arrijë të tjetërsojë të gjitha asetet , ndaj duhet të kryhet bllokimi i aksioneve të debitorit **Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.A. (*OSHEE*)** me qëllim mostjetërsimin e tyre për tu shmangur nga detyrimi , gjithashtu të kryhet bllokimi i aksioneve që OSHEE zotëron në shoqëritë : "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sha me Nipt L81530018E , "Furnizuesi i

Shërbimit Universal" sha me Nipt L81530016L dhe "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sha me Nipt L81530029T.

*<u>Mbështetur në nenet 519 ,527, 593 të Kodit të Proçedures Civile në nenit 36/3, dhe 53 i Ligjit 26/2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat" .</u>*

**URDHËROJMË**

1. Vënien e masës së sekuestros konservative mbi aksionet e debitorit **Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.A. (*OSHEE*)** me qëllim mostjetërsimin e tyre për tu shmangur nga detyrimi për ekzekutimin e Urdhërit Ekzekutimit .
2. Vënien e masës së sekuestros konservative mbi aksionet/kuotat që OSHEE zotëron në shoqëritë : "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sha me Nipt L81530018E , "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sha me Nipt L81530016L dhe "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sha me Nipt L81530029T me qëllim mostjetërsimin e tyre, deri në një urdhër të dytë të Shoqërisë Përmbarimore Gjyqësore Private "**PETANI BAILIFF'S OFFICE**" shpk.
3. Për veprimet apo mosveprimet tuaja na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
4. Personat që bëhen pengesë do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të Kodit të Proçedurës Civile.
5. Ky urdhër mbahet në disa kopje dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brënda 5 ditëve.

**SHOQËRIA PËRMBARIMORE PRIVATE**

**"PETANI BAILIFF'S OFFICE" SHPK**

**ADMINISTRATOR**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
HARILLA A. ÇIPI
PËRMBARUES GJYQËSOR

**HARILLA A. ÇIPI**